

MFE Nr. 4174

Dt. 01/03/2021

Nr. 184 prot.

DPP1 Dt: 01.03.2021

Marrëveshje

ndërmjet

**Konfederatës Zvicerane,
e përfaqësuar nga
Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO)**

dhe

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së
Shqipërisë**

për

**Projektin Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale
(ALSIP)**

Faza 1, 2020-2025

Konfederata Zvicerane, e përfaqësuar nga **Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike**, dhe

Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë,

NË MBËSHTETJE dhe zbatim të Marrëveshjes Kuadër midis Këshillit Federal dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik, Financiar dhe Humanitar, të lidhur dhe nënshkruar në Tiranë më 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr.9801, datë 13 shtator 2007,

MË DËSHIRËN për të forcuar më tej këto marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunim të frytshëm midis dy vendeve,

ME QËLLIM nxitjen e mëtejshme të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në Republikën e Shqipërisë,

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e reformave për krijimin e ekonomisë së tregut në kushte demokratike dhe për sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e tashëm dhe të ardhshëm,

Bien dakord si më poshtë vijon:

Neni I Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje Projekti, përveç se kur konteksti kërkon ndryshe, termat në vijim kanë kuptimin e dhënë më poshtë:

- a. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë.
- b. "Qeveria Zvicerane" do të thotë Qeveria e Konfederatës Zvicerane (Këshilli Federal Zviceran), e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike.
- c. "MFE" do të thotë Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë.
- d. "SECO" do të thotë Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike i Konfederatës Zvicerane.
- e. "Palët e Kontraktuese" do të thotë Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane.
- f. "IPI" do të thotë Instituti Federal Zviceran i Pronësisë Intelektuale, që është kontraktuar nga SECO për zbatimin e Projektit në fjalë në emër të SECO-s.
- g. "DPPI" do të thotë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së

Shqipërisë.

- h. "Projekti", përkatësisht "Projekti Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale (ALSIP)", do të thotë projekti i asistencës teknike për forcimin e sistemit shqiptar të drejtave të pronësisë intelektuale, me qëllim që të kontribuojë për një ndikim pozitiv në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë, i financuar nga SECO në përputhje me këtë Marrëveshje Projekti. Objekti i punës së projektit është i shtjelluar në Përmbledhjen e Përgjithshme të Projektit. Në rast mospërputhje midis Përmbledhjes së Përgjithshme të Projektit "ALSIP" dhe kësaj Projekt-marrëveshjeje, mbizotëron kjo Marrëveshje.
- i. "Kohëzgjatja e Projektit" do të thotë periudha e zbatimit të Projektit duke nisur nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Projektit, deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të përcaktuara në të, por jo përtej datës 31 dhjetor 2025.
- j. "Kontribut" do të thotë një kontribut i parimbursueshëm i bërë nga SECO në kuadër të kësaj Projekt-marrëveshjeje.
- k. "EMP" do të thotë Ekipi i përbashkët i Menaxhimit të Projektit i përbërë nga IPI dhe DPPI. Ai është i ngarkuar me bashkërendimin dhe zbatimin e përditshëm të projektit në nivel operacional.
- l. "DPI" do të thotë të Drejtat e Pronësisë Intelektuale.
- m. "PP" është Përgjegjësi i Projektit, që caktohet nga IPI me qëllim që të veprojë si përfaqësuesi vendor i IPI-së në Shqipëri.
- n. "PKK" do të thotë Pika Kombëtare e Kontaktit, që caktohet nga DPPI me qëllim që të veprojë si përfaqësuesi i saj zyrtar për projektin.
- o. "KD" do të thotë Komiteti Drejtues që siguron drejtimin strategjik për zbatimin e Projektit.
- p. "TVSH" do të thotë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar.

Neni II Objekti i Marrëveshjes

1. Marrëveshja e Projektit do të mbulojë të gjitha veprimtaritë e përcaktuara në Përmbledhjen e Përgjithshme të Projektit, e cila i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje.

Neni III Objektivi dhe Objekti i Projektit

- 1 Kjo Marrëveshje Projekti përcakton Projektin Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale dhe zbatimin e tij.

Marrëveshje

ndërmjet

**Konfederatës Zvicerane,
e përfaqësuar nga
Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO)**

dhe

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së
Shqipërisë**

për

**Projektin Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale
(ALSIP)**

Faza 1, 2020-2025

Konfederata Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike, dhe

Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë,

NË MBËSHTETJE dhe zbatim të Marrëveshjes Kuadër midis Këshillit Federal dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunim Teknik, Financiar dhe Humanitar, të lidhur dhe nënshkruar në Tiranë më 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr.9801, datë 13 shtator 2007,

MË DËSHIRËN për të forcuar më tej këto marrëdhënie miqësore dhe bashkëpunim të frytshëm midis dy vendeve,

ME QËLLIM nxitjen e mëtejshme të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në Republikën e Shqipërisë,

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e reformave për krijimin e ekonomisë së tregut në kushte demokratike dhe për sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e tashëm dhe të ardhshëm,

Bien dakord si më poshtë vijon:

Neni I Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje Projekti, përveç se kur konteksti kërkon ndryshe, termat në vijim kanë kuptimin e dhënë më poshtë:

- a. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë.
- b. "Qeveria Zvicerane" do të thotë Qeveria e Konfederatës Zvicerane (Këshilli Federal Zviceran), e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike.
- c. "MFE" do të thotë Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë.
- d. "SECO" do të thotë Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike i Konfederatës Zvicerane.
- e. "Palët e Kontraktuese" do të thotë Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane.
- f. "IPI" do të thotë Instituti Federal Zviceran i Pronësisë Intelektuale, që është kontraktuar nga SECO për zbatimin e Projektit në fjalë në emër të SECO-s.
- g. "DPPI" do të thotë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e Republikës së

Shqipërisë.

- h. "Projekti", përkatësisht "Projekti Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale (ALSIP)", do të thotë projekti i asistencës teknike për forcimin e sistemit shqiptar të të drejtave të pronësisë intelektuale, me qëllim që të kontribuojë për një ndikim pozitiv në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë, i financuar nga SECO në përputhje me këtë Marrëveshje Projekti. Objekti i punës së projektit është i shtjelluar në Përmbledhjen e Përgjithshme të Projektit. Në rast mospërputhje midis Përmbledhjes së Përgjithshme të Projektit "ALSIP" dhe kësaj Projekt-marrëveshjeje, mbizotëron kjo Marrëveshje.
- i. "Kohëzgjatja e Projektit" do të thotë periudha e zbatimit të Projektit duke nisur nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Projektit, deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të përcaktuara në të, por jo përtej datës 31 dhjetor 2025.
- j. "Kontribut" do të thotë një kontribut i parimbursueshëm i bërë nga SECO në kuadër të kësaj Projekt-marrëveshjeje.
- k. "EMP" do të thotë Ekipi i përbashkët i Menaxhimit të Projektit i përbërë nga IPI dhe DPPI. Ai është i ngarkuar me bashkërendimin dhe zbatimin e përditshëm të projektit në nivel operacional.
- l. "DPI" do të thotë të Drejtat e Pronësisë Intelektuale.
- m. "PP" është Përgjegjësi i Projektit, që caktohet nga IPI me qëllim që të veprojë si përfaqësuesi vendor i IPI-së në Shqipëri.
- n. "PKK" do të thotë Pika Kombëtare e Kontaktit, që caktohet nga DPPI me qëllim që të veprojë si përfaqësuesi i saj zyrtar për projektin.
- o. "KD" do të thotë Komiteti Drejtues që siguron drejtimin strategjik për zbatimin e Projektit.
- p. "TVSH" do të thotë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar.

Neni II Objekti i Marrëveshjes

1. Marrëveshja e Projektit do të mbulojë të gjitha veprimtaritë e përcaktuara në Përmbledhjen e Përgjithshme të Projektit, e cila i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje.

Neni III Objektivi dhe Objekti i Projektit

- 1 Kjo Marrëveshje Projekti përcakton Projektin Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale dhe zbatimin e tij.

- 2 Qeveria e Zvicrës është e angazhuar të mbështesë Qeverinë e Republikës së Shqipërisë në përpjekjet e saj për të lehtësuar tregtinë dhe investimet përmes nxitjes së mbrojtjes dhe përdorimit të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (DPI-të). Objektivi i përgjithshëm i Projektit sa i përket zhvillimit, është të japë kontribut në mënyrë që sipërmarrësit, krijuesit, studiuesit dhe prodhuesit në Shqipëri të përfitojnë nga një mbrojtje efikase e objekteve të PI-së. Më konkretisht, Projekti do të ofrojë asistencë teknike, nxitje të punës kërkimore, praktikat më të mira të informacionit, promovimit dhe zhvillim kapacitetesh me qëllim mbështetjen arritjen e përfundimeve të pritshme si më poshtë:
- a) Legjislacioni i përmirësuar për PI-në dhe zbatimi efikas i strategjisë kombëtare për PI-në japin kontribut për kushte më të mira për investim dhe inovacion;
 - b) Subjektet mirëfunksionuese të regjistrimit dhe administrimit të DPI-ve ofrojnë shërbime të efektshme dhe të lehta në përdorim;
 - c) Subjektet e DPI-ve, përfaqësuesit e sektorit privat dhe akademikëve forcohen lidhur me nxitjen e blerjes, përdorimit dhe transferimit të DPI-ve tek përdoruesit e mundshëm;
 - d) Forcohet më tej zbatimi i DPI-ve;
 - e) Rritet ndërgjegjësimi lidhur me rëndësinë e Qendrave të Transferimit të Teknologjisë (QTT) dhe komercializimin e DPI-ve në kuadër të procesit të inovacionit.

Neni IV Përgjegjësitë dhe Kontributet

1 Përgjegjësitë dhe kontributete DPPI-së:

- a) DPPI-ja siguron burimet të mjaftueshme njerëzore dhe logjistike për zbatimin e efektshëm dhe në kohë të Projektit. DPPI-ja siguron veçanërisht personel të mjaftueshëm për të marrë pronësi të plotë të Projektit dhe për të punuar në mënyrë proaktive për garantimin e qëndrueshmërisë së rezultateve të tij të përcaktuara në Përmbledhjen e Përgjithshme të Projektit.
- b) DPPI-ja siguron bashkërendimin me institucione të tjera shtetërore të përfshira në zbatimin e Projektit.
- c) DPPI-ja cakton një PKK nga niveli i lartë drejtues si kontribut në natyrë për Projektin. PKK-ja shqiptare është përgjegjëse për zbatimin e veprimtarive të Projektit që lidhen me DPPI-në dhe për sigurimin e bashkëpunimit efikas me administratën publike shqiptare, duke qenë se DPPI-ja është subjekti bashkërendues i Strategjisë Kombëtare për PI-në. PKK-ja shqiptare bashkëpunon ngushtë me PP-në në kuadrin e EMP-së për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e veprimtarive të Projektit. Më konkretisht, PKK-ja e DPPI-së i kushton të paktën 6 ditë në muaj Projektit.

- d) DPPI-ja mbulon dhe/ose lehtëson të gjitha kontributet e qeverisë për ekspertët dhe pjesëmarrjen në trajnime apo veprimtaritë e përcaktuara në Nenin VII.3 të kësaj Projekt-marrëveshjeje, si dhe ambientet brenda objekteve shtetërore që lidhen me institucionet përkatëse qeveritare.
- e) DPPI-ja siguron të dhënat dhe statistikat e disponueshme për matjen e rezultateve të projektit.
- f) DPPI-ja siguron zbatimin e privilegjeve sipas përcaktimeve të Nenit XI më poshtë.
- g) DPPI-ja njihet rolin e Zvicrës, SECO-s dhe IPI-së në mbështetje të Projektit dhe në çdo raport apo dokument të publikuar në kontekstin e zbatimit të Projektit, dhe i siguron SECO-s një kopje të këtyre publikimeve/raporteve.
- h) Kontributet në natyrë të DPPI-së dhe organeve të tjera qeveritare përcaktohen bashkërisht dhe arrihet marrëveshje me IPI-në çdo vit, për t'i shërbyer nevojave të ciklit buxhetor të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
- i) DPPI-ja sigurohet që të gjitha organet përkatëse, të përfshira në veprimtaritë e projektit, marrin pjesë me kontribute që lidhen me veprimtarinë përkatëse të projektit dhe që të caktojnë një pikë kontakti brenda organit për të gjitha komunikimet që lidhen me zbatimin e projektit.

2. Përgjegjësitë dhe kontributete SECO-s:

- a) SECO ka kontraktuar Institutin Federal Zviceran të Pronësisë Intelektuale (IPI) për zbatimin e Projektit në emër të saj.
- b) SECO financon Kontributin Zviceran për projektin, sipas përcaktimit të Nenit VI.
- c) SECO/Ambasada e Zvicrës në Tiranë merr pjesë në Komitetin Drejtues të projektit dhe vijon një dialog të rregullt me palën Kontraktuese me qëllim dhënien e ndihmës në zbatim dhe për të siguruar bashkërendimin dhe koherencën strategjike në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar Zviceran në Shqipëri.

3. Përgjegjësitë dhe kontributete Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:

- a) Ministria e Financave dhe Ekonomisë vë në dispozicion shumat e nevojshme buxhetore për rimbursimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për Projektin në një shumë maksimale prej CHF 89'780 (tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë Franga Zvicerane) gjatë periudhës gjashtë vjeçare 2020-2025.

4. Përgjegjësitë dhe kontributet e Drejtorisë për të Drejtat e Autorit:

- a) DDA-ja krijohet si strukturë pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtat e autorit dhe

Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service

ushtron veprimtarinë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.03.2016.
"Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me to"

- b) Kontributet në natyrë të DDA-së dhe organeve të tjera qeveritare përcaktohen bashkërisht dhe arrihet marrëveshje me IPI-në çdo vit, për t'i shërbyer nevojave të ciklit buxhetor të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

4 Kontributet e Përbashkëta:

- a) Palët e Kontratës sigurojnë gjithashtu që rezultatet e Projektit të zbatohen në mënyrë afatgjatë dhe të qëndrueshme.

Neni V Organizimi dhe Zbatimi i Projektit

1. Projekt do të zbatohet bashkërisht nga DPPI-ja dhe IPI-ja, ku ky i fundit, është agjencia zbatuese e SECO-s. DPPI-ja bashkërendon me të gjitha agjencitë qeveritare shqiptare të përfshira dhe organet jo-qeveritare, në varësi të veprimtarive specifike dhe përgjegjësi institucionale, në kuadrin e zbatimit të mëtejshëm të këtij Projekti dhe mund të ftojë agjencitë përkatëse në mbledhjet e KD-së.
2. IPI-ja është përgjegjëse për zbatimin si dhe për administrimin e përgjithshëm dhe atë financiar të projektit. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, për përgjegjësinë për shpenzimet dhe pagesën e drejtuesve, prokurimin e ekspertëve të jashtëm, administrimin e procedurave të prokurimit, përpilimin e planeve vjetore të punës dhe dorëzimin e raporteve të zbatimit tek SECO.
3. Koordinator i Projektit i IPI-së në Bern, është përgjegjës për projektin në përgjithësi dhe administrimin e fondeve, si dhe për identifikimin e ekspertizës ndërkombëtare.
4. IPI-ja siguron prurje të ekspertëve ndërkombëtarë dhe ka një funksion mbështetjeje teknike lidhur me DPI-të.
5. IPI përzgjedh dhe emëron PP vendor, në përputhje me legjislacionin Zviceran për prokurimin, pas marrjes së pëlqimit nga SECO dhe DPPI. Organizata partnere vendore e përzgjedhur është Swisscontact Shqipëria, në të cilën është vendosur PP vendor. Swisscontact Shqipëria u përzgjedh për shkak të reputacionit të shkëlqyer, ekspertizës së bashkëpunimit teknik, si dhe për sinergjitë potenciale me projekte të tjera të bashkëpunimit Zvicerian në Shqipëri.
6. PP është përgjegjës për administrimin vendor të projektit nën drejtimin e drejtuesve të përgjithshëm të projektit në IPI dhe është veçanërisht përgjegjës për administrimin, zbatimin e veprimtarive vendore, kontabilitetin, kontraktimin vendor, dhe monitorimin e Projektit, si dhe përfaqësimin e IPI-së në Shqipëri. PP i raporton drejtpërsëdrejti IPI-së dhe paguhet nga Kontributi Zviceran.

7. Përfaqësuesit e IPI-së dhe DPPI-së, që përbëjnë EMP-në, bashkërendojnë së bashku veprimtaritë e Projektit në Shqipëri, bashkë me përfaqësues të organeve të tjera të sistemit kombëtar shqiptar të PI-së, sipas përgjegjësiwe përkatëse institucionale. Për më tepër, ata bashkërisht sigurojnë zbatimin dhe administrimin e përditshëm të Projektit, duke siguruar përmbushjen e objektivave të Projektit brenda afateve dhe buxhetit të disponueshëm.
8. KD përbëhet nga: (a) Koordinator i Projektit nga IPI me qendër në Bern, (b) përfaqësuesi i SECO-s/Ambasadës të Zvicrës në Tiranë dhe (c) Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së. KD-ja siguron drejtim dhe mbështetje strategjike për zbatimin e suksesshëm të veprimtarive të Projektit dhe arrijtjen e rezultateve të pritshme, si dhe bën të mundur transparencën dhe mëkon pronësinë e Projektit tek palët kryesore të interesit. Të gjithë partnerët e tjerë të projektit ftohen të marrin pjesë me qëllim sigurimin e bashkërendimit dhe dialogut të vazhdueshëm. KD-ja miraton planet e punës dhe raportet e zbatimit, përfshirë raportet financiare. KD-ja mbledhet dy herë në vit në Tiranë.
9. Të gjitha ndryshimet strategjike të Projekti duhet të miratohen zyrtarisht nga SECO, IPI-ja, dhe DPPI-ja. Për sa është e mundur, kjo arrihet përmes komunikimeve me postë elektronike. Vizitat e rregullta të përfaqësuesve të SECO-s dhe ekspertëve të IPI-së në Tiranë përcaktohen për çështjet e vendim marrjes, sipas nevojës.

Neni VI Shuma dhe Përdorimi i Kontributit Zviceran

SECO zoton fonde në formën e një granti të parimbursueshëm deri në një vlerë maksimale prej 1'500'000 CHF (një milion e pesëqind mijë Franga Zvicerane), sipas Përmbledhjes së Përgjithshme të Projektit.

Neni VII Buxhetimi dhe Lëvrimi i Fondeve të Projektit

- 1 EMP përgatit një **Plan vjetor operacionesh të projektit, duke përfshirë edhe kontributin shqiptar**. Plani i parë vjetor hartohet nga EMP në momentin e hapjes së Projektit. Plani vjetor mund të ndryshohet me marrëveshje të ndërsjelltë midis IPI-së dhe DPPI-së, dhe me pëlqimin e SECO-s, por buxheti maksimal dhe objektivat e përgjithshëm, të përvijuara në Dokumentin e Projektit, duhet të respektohen.
- 2 **Administrimi i buxhetit**: Buxheti i Projektit për zbatimin e veprimtarive të Projektit në Shqipëri administrohet nga PP-ja. Të gjitha shpenzimet e Projektit në Shqipëri gjithashtu miratohen nga PP-ja. Shpenzimet që tejkalojnë zërat e buxhetit të Projektit, ose që nuk janë të përcaktuara shprehimisht në të, do të miratohen nga IPI-ja. DPPI-ja nuk merr asnjë akordim në të holla nga kontributi i SECO-s dhe as nuk e administron këtë fond.
- 3 **Rindarja e kostove midis burimeve të Projektit dhe burimeve të DPPI-së**: DPPI do të mbulojë shpenzimet, dietat e punonjësve të saj në organizimin e aktiviteteve jashtë vendit

të punës brenda Shqipërisë apo veprimtari të tjera dhe cdo institucion përfitues do të mbulojë shpenzimet e dietave për punonjësit e saj respektivisht sipas fushës së përgjegjësisë.

4. Projekti financon **kontributet jo qeveritare për ekspertët**, që janë:

- a) Kontributet jo qeveritare për ekspertët: Transportimi me distancë të largët midis qyteteve brenda Shqipërisë dhe fluturimet ndërkombëtare, si dhe ushqimin, pijet, dhe akomodimin gjatë veprimtarive (brenda dhe jashtë Tiranës).
- b) Ambientet jashtë objekteve shtetërore, vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur ambientet shtetërore nuk janë të disponueshme.
- c) Udhëtimet e studimit dhe trajnimet jashtë vendit: Dietat ditore për personelin shtetëror dhe ata që marrin pjesë në udhëtimet e studimit dhe trajnimet jashtë vendit, sipas rregulloreve të projektit për veprimtaritë dhe udhëtimet. Në rast të mbulimit të kostove të udhëtimit nga ana e projektit, zbatohen rregullat e projektit dhe jo ato të qeverisë.
- d) Fondet/Pagesat, objekt i kësaj marrëveshjeje, të destinuara për Përfituesin sipas qëllimit të përcaktuar, duke përfshirë këtu por pa u kufizuar vetëm, tek të gjitha tëmirat materiale dhe jo materiale që rrjedhin prej tyre, nuk i nënshtrohen sekuestrimit, konfiskimit apo çdo lloj forme tjetër ndalimi nga palët e treta, ose që vjen si rezultat i një mase gjyqësore në favor të palëve të treta. Në të njëjtën kohë, Përfituesi nuk mund të privohet nga pagesa apo kontribute nga kreditori, si pasojë e procedurave të sekuestrimit, konfiskimit apo të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor.

Neni VIII Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi

- 1 **Monitorimi i arritjes së objektivave dhe rezultateve të Projektit:** Afatet e zbatimit të Projektit, sipas përcaktimit të tyre në Përmbledhjen e Përgjithshme të Projektit, përbëjnë bazën për monitorimin e arritjes së objektivave dhe rezultateve të projektit. Këto veprimtari monitorimi pasqyrojnë ndryshimet e mundshme të objektivave dhe produkteve të Projektit që gjejnë dakordësinë e Komitetit Drejtues të përbërë nga SECO, DPPI-ja dhe IPI-ja.
- 2 **Monitorimi i ecursisë së Projektit:** IPI-ja është përgjegjëse për monitorimin e projektit me përfshirjen aktive të DPPI-së dhe subjekteve të tjera partnere të projektit, sipas përcaktimit të roleve të tyre institucional dhe përgjegjësi tematike.

DPPI-ja i siguron IPI-së të dhënat dhe statistikën e disponueshme me qëllim matjen e rezultateve të projektit, si të dhënat për regjistrimin e patentave dhe markave të regjistruara, informacion për rishikimet ligjore ose ligjet e reja përkatëse, rregullat dhe rregulloret në fuqi, etj., të cilat bëhen pjesë e monitorimit të projektit nga ana e IPI-së. DPPI-ja lehtëson marrjen e të dhënave nga organe të tjera shtetërore.

- 3 **Raportimi:** Raportimi kryhet në kontekstin e raportimit të përgjithshëm të raportimit një herë në dy vjet në kuadrin e Programit Botëror për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (PBDPI) midis SECO-s dhe IPI-së. Raportimi është përgjegjësi e IPI-së.
- 4 **Vlerësimi:** Në kuadrin e Projektit parashikohet dhe buxhetohet një vlerësim i jashtëm afatmesëm, që kryhet në përputhje me udhëzimet e SECO-s për vlerësimin.

Neni IX Dispozita Anti-Korrupsion dhe të Drejtat e Njeriut

Palët e Kontratës ndajnë një shqetësim të përbashkët lidhur në luftën kundër korrupsionit, që kërcënon qeverisjen e mirë dhe përdorimin e mirë të burimeve të nevojshme për zhvillim dhe për më tepër, rrezikon konkurrencën e drejtë dhe të hapur të bazuar në çmim dhe cilësi. Kështu, Palët e Kontratës deklarojnë qëllimin e tyre për të bashkuar përpjekjet e tyre për të luftuar korrupsionin, dhe në veçanti deklarojnë se çdo ofertë, dhuratë, pagesë, shpërblim apo përfitim i çfarëdolloji, për këdo, dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me qëllim përftimin e një mandati apo kontrate në kuadrin e kësaj Projekt-Marrëveshjeje ose gjatë zbatimit të saj, konsiderohet si vepër e jashtëligjshme dhe praktikë korrupsioni. Çdo vepër e këtij lloji përbën baza të mjaftueshme për të justifikuar anulimin e menjëhershëm të kësaj Marrëveshjeje Projekti, apo të prokurimit apo kontratës përkatëse, apo edhe për marrjen e çdo mase tjetër korrigjuese të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Respektimi i parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut, veçanërisht sipas përcaktimeve të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, përbën bazën e politikave të brendshme dhe ndërkombëtare të Palëve të Kontratës dhe drejtojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Projekti.

Neni X Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Të gjitha dallimet apo mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Projekt-Marrëveshjeje zgjidhen miqësisht më konsultim midis dy Palëve të Kontratës.

Neni XI Lehtësirat e Siguruara

DPPI-ja siguron dhe/ose lehtëson të gjitha kontributet e qeverisë për ekspertët vendorë dhe pjesëmarrjen e personelit shtetëror në trajnimet apo veprimtaritë, si dhe ambientet brenda objekteve shtetërore, sipas përcaktimeve të Nenit VII.3.

Neni XII Pronësia Intelektuale dhe Publikimet

- 1 Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale për materiale si informacion, materiale trajnimi, publikime dhe logo të mundësuar nga organizatat/agjencitë pjesëmarrëse për përdorim në zbatimin e veprimtarive në kuadër të kësaj Projekt-marrëveshjeje, gëzohen nga DPPI-ja, IPI-ja dhe SECO, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe me shkrim.
- 2 Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale mbi materiale si informacioni, materialet e trajnimit, publikimet dhe logot që krijohen bashkërisht nga organizatat/agjencitë pjesëmarrëse në kuadër të kësaj Projekt-marrëveshjeje, janë pronë e palëve të përfshira. Në këto raste, palët e përfshira vendosin bashkërisht rregullat për përdorimin e këtyre materialeve.
- 3 DPPI-ja dhe partnerët e tjerë qeveritarë i sigurojnë SECO-s kopje të të gjitha raporteve apo materialeve të publikuara në kuadër të Projektit dhe njohin rolin e Zvicrës/SECO-s si mbështetës i Projektit në të gjitha raportet apo materialet e publikuara në kontekstin e zbatimit të Projektit.
- 4 Çdo Palë e Kontratës sigurohet që të gjitha të dhënat dhe/ose informacionet e vëna në dispozicion dhe/ose që vijnë si rrjedhojë e veprimtarive të përbashkëta të zbatuara gjatë periudhës së zbatimit të kësaj Projekt-marrëveshjeje nuk i transferohen apo i vihen në dispozicion një pale tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër të Kontratës.
- 5 Palët e Kontratës bien dakord se dispozita e Pikës 4 e këtij Nenin XII vijon të shtrijë efektin e saj detyrues pavarësisht ndërprerjes dhe/ose përfundimit të kësaj Projekt-marrëveshjeje.

NENI XIII Autoritetet

Autoritetet e mëposhtme janë përgjegjëse për zbatimin e kësaj Projekt-Marrëveshjeje:

Për Sekretariatën Shtetërore Zviceranë për Çështjet Ekonomike:

Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike
Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin
Nxitjen e Tregtisë/WEHU
Holzikofenëg 36
3003 Bern, Zvicër

Përfaqësuar nga:
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri
Rruga Ibrahim Rugova Nr. 3/1
1019 Tiranë, Shqipëri

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33

Shtëpia e Ushtarakëve
Tiranë, Shqipëri

Neni XIV Ndryshimet, Shtesat

1. Ndryshimet dhe/ose shtesat e kësaj Projekt-Marrëveshjeje bëhen me shkrim me pëlqimin e të dy Palëve të Kontratës.

Neni XV Përbërësit

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kësaj Projekt-Marrëveshjeje:

- a) Shtojca 1: Përmbledhje e Përgjithshme e Projektit
- b) Shtojca 2: Kuadri Logjik
- c) Shtojca 3: Afatet e Zbatimit të Projektit

Neni XVI Hyrja në Fuqi, Pezullimi dhe Ndërprerja

- 1 Kjo Marrëveshje Projekti hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy Palët e Kontratës dhe qëndron në fuqi deri në përmbylljen e të gjitha detyrimeve të përcaktuara në të, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2025. Vlefshmëria e kësaj Projekt-Marrëveshjeje mund të shtyhet përmes një marrëveshjeje me shkrim midis Palëve të Kontratës.
- 2 Megjithatë, nëse njëra nga Palët, përpara përfundimit të kësaj Projekt-Marrëveshjeje sipas Nenit XVI.1, gjykon se qëllimet e veta nuk mund të arrihen më, ose që Pala tjetër nuk po përmbyll detyrimet e saj, ajo ka të drejtën të pezullojë ose ndërpresë këtë Marrëveshje Projekti duke bërë një njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, secila Palë e Kontratës mund të ndërpresë këtë Projekt-Marrëveshjeje me efekte të menjëhershme në rast të ndonjë shkeljeje përmbytësore të Projekt-Marrëveshjes. Shkelje përmbytësore do të thotë shkelje të një prej objektivave apo dispozitave thelbësore të kësaj Projekt-Marrëveshjeje.
- 3 Në rast të ndërprerjes së saj sipas Nenit XVI.2, dispozitat e kësaj Projekt-Marrëveshjeje vijojnë të mbeten në fuqi për të gjitha kontratat në zbatim e sipër në momentin e ndërprerjes së saj, dhe deri në përmbylljen e duhur të detyrimeve të kontratësapo kanë përfunduar në kohë ndërprerjen.
4. Në rast se njëra nga Palët e Kontratës ose një prej përfaqësuesve të saj zbatues dështon në përmbylljen e parimeve bazë apo ndonjë angazhimi apo detyrimi në kuadrin e kësaj Projekt-marrëveshjeje, Pala tjetër e Kontratës mund të paralajmërojë pezullimin e zbatimit të Marrëveshjes së Projektit.


5. Palët e Kontratës përpqen të zgjidhin çështjen që ka sjellë pezullimin përmes negociatave dhe rrugëve diplomatike.
- 6 Nëse shkaku i pezullimit nuk është zgjidhur brenda një periudhe gjashtë mujore, Pala e Kontratës në fjalë mund të ndërpresë menjëherë Marrëveshjen e Projektit.

Kjo Marrëveshje Projekti është hartuar në dy kopje origjinale me përmbajtje identike, një në gjuhën angleze dhe një në gjuhën shqipe.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, do të mbizotëroje teksti në gjuhën Angleze.

Palët e mëposhtme konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të përpiluar në Tiranë më datë 01/03/2021.

Në emër Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë



Ministria e Financave dhe Ekonomisë



Shkëlqesia e Saj Anila Denaj
Ministër



Lexuar dhe Rënë Dakord


Drejtorja e Përgjithshme e Pronësive Industriale

Znj. Ledina Beqiraj Agalliu
Drejtor i Përgjithshëm



Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Shkëlqesia e Tij Adrian Maître
Ambasador



Shtojca 1

